



SIGMA
Creating Change Together



A joint initiative of the OECD and the EU,
principally financed by the EU

Parimet e Administratës Publike

Botim i vitit 2017



Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit SIGMA.

Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian (BE). Ai nuk duhet të paraqitet si dokument që përfaqëson pikëpamjet zyrtare të BE-së, OECD-së ose vendeve anëtare të saj, apo të partnerëve që marrin pjesë në programin SIGMA. Mendimet e shprehura dhe argumentet e përdorura në këtë dokument janë ato të autorëve.

Ky dokument, si dhe të gjitha të dhënat dhe hartat e përfshira këtu, nuk cenojnë statusin apo sovranitetin e ndonjë territori, as përcaktimin e kufijve ndërkombëtarë dhe as emrin e ndonjë territori, qyteti apo zone.

© OECD 2017 - Përdorimi i këtij dokumenti, qoftë në formë elektronike apo të printuar, rregullohet në bazë të termave dhe kushteve që ndodhen në faqen e internetit të OECD-së <http://www.oecd.org/termsandconditions>.

Tabela e përmbajtjes

Parathënie nga Johannes Hahn, Komisioner për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, KE	2
Parathënie nga Mari Kiviniemi, Zëvendës Sekretare e Përgjithshme, OECD	3
Hyrje	4
1. Korniza Strategjike e Reformës së Administratës Publike	7
2. Zhvillimi dhe koordinimi i politikave	10
3. Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore	14
4. Llogaridhënia	17
5. Ofrimi i shërbimeve	20
6. Menaxhimi financiar publik	23
Shënime fundore	28
Për më shumë lexoni Parimet e Administratës Publike	29



Parathënie

Johannes Hahn

Komisioner për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit, KE

Komisioni Evropian (KE) i kushton një vëmendje të madhe trajtimit të reformave themelore në fazat e hershme të procesit të zgjerimit. Kjo qasje kontribuon në forcimin e besueshmërisë së politikës së zgjerimit dhe në përmirësimin e fuqisë së saj transformuese.

Reforma e administratës publike (RAP) është një shtyllë e procesit të zgjerimit, bashkë me shtetin e së drejtës dhe qeverisjen ekonomike. Të tri këto shtylla janë të lidhura ngushtë dhe përbëjnë çështje ndërsektoriale me rëndësi thelbësore për suksesin e reformave politike dhe ekonomike dhe për krijimin e bazës së zbatimit të rregullave dhe standardeve të Bashkimit Evropian (BE-së). Një administratë publike që funksionon mirë është e domosdoshme për qeverisjen demokratike. Gjithashtu, ajo ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e qeverive për të ofruar shërbime publike dhe për të rritur konkurrencën dhe zhvillimin.

Reforma e administratës publike duhet të çojë në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit dhe të sigurojë një fokus më të madh në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Një shërbim civil i menaxhuar në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale, planifikimi dhe koordinimi më i mirë i politikave, procedurat e mira

administrative dhe menaxhimi më i mirë i financave publike kanë rëndësi thelbësore për funksionimin e shtetit dhe për zbatimin e reformave që nevojiten për integrimin në BE. Vendet duhet të shtojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar administratat e tyre publike në të gjitha nivelet në bazë të strategjive kombëtare. Për të drejtuar procesin e reformave kërkohet një përkushtim i fuqishëm politik.

Duke njohur sfidat me të cilat përballen vendet e zgjerimit, KE-ja po forcon mbështetjen e tij për RAP-in. KE-ja synon të shfrytëzojë maksimalisht mekanizmat dhe forumet ekzistuese për të çuar përpara reformat, qoftë përmes strukturave të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit, negociatave për anëtarësim ose iniciativave të udhëhequra nga KE-ja me synime të qarta për vendet specifike. KE-ja po fut gjithashtu edhe një dialog më të strukturuar të politikave për RAP-in me vendet e zgjerimit në Grupet Speciale të RAP-it.

Parimet e Administratës Publike të paraqitura në këtë botim, që janë rezultat i një partneriteti të suksesshëm afatgjatë mes KE-së dhe SIGMA-s, do të lehtësojnë në masë të madhe progresin e kësaj agjende sfiduese.

Parathënie

Mari Kiviniemi

Zëvendës Sekretare e Përgjithshme, OECD



Qeverisja e mirë dhe një administratë publike që funksionon mirë janë thelbësore për krijimin dhe ruajtjen e besimit ndaj qeverisë, dhe për krijimin e reformave të nevojshme strukturore për rritjen e standardeve të jetesës në shoqëri. Rëndësia e një administrate të mirë është bërë e evidente veçanërisht gjatë krizës financiare globale. Burimet e kufizuara i fokusuan diskutimet e nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar në punën e qeverisë, duke e bërë të qartë se qeverisja e mirë ka ndikim të madh në mënyrën se si kthehen paratë që janë në dispozicion në produkte dhe në rezultate sistemike.

Kjo është një sfidë e njohur për qeveritë e vendeve që synojnë integrimin në Bashkimin Evropian (BE), pasi procesi i anëtarësimit kërkon që të bëhen reforma thelbësore në rrethana financiare që shpesh janë të kufizuara.

OECD-ja dhe Komisioni Evropian (KE) kanë bashkuar forcat e tyre për më shumë se 25 vjet përmes iniciativës së SIGMA-s. Ajo jep mbështetje për forcimin e administratave publike dhe për zbatimin e reformave qeverisëse në vendet kandidatë potenciale për anëtarësim dhe në vendet fqinje të BE-së.

Parimet e Administratës Publike janë rezultat i këtij bashkëpunimi të suksesshëm. Ato kombinojnë dinamikën

e procesit të anëtarësimit në BE me ekspertizën e OECD-së për qeverisjen dhe bashkojnë dekada të tëra përvoja si nga vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ashtu edhe nga vendet anëtare të BE-së, duke përfshirë edhe vendet të cilat kanë kaluar nëpër procesin e anëtarësimit. Parimet ofrojnë një përkufizim të detajuar të administratës së mirë publike, të cilën duhet ta synojnë vendet. Për herë të parë, Parimet ofrojnë një kuadër monitorimi në mënyrë që qeveritë dhe politikë-bërësit të mund të ndjekin zbatimin e reformave të nevojshme gjatë kohës.

Përmes një fokusimi të fortë në zbatimin e reformave dhe mbledhjes së provave mbi performancën e qeverisë, Parimet nuk paraqesin vetëm një grup kushtesh dhe kërkesash, por ato ndihmojnë gjithashtu edhe në formulimin e vizionit të reformës së administratës publike (RAP) dhe shërbejnë si mjet ndihmës për vendimmarrësit kryesorë.

E marrë në tërësi korniza e re e përforcuar e RAP-it do të fokusojë më mirë përpjekjet e përbashkëta të qeverive, të KE-së dhe të OECD-së për përmirësimin e performancës së administratave publike.

REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE ËSHTË THELBËSORE PËR PROCESIN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

Administrata publike që funksionon mirë përbën parakusht për qeverisje demokratike transparente dhe efikase. Ajo është themeli i funksionimit të shtetit, përcakton aftësinë e qeverisë për të ofruar shërbime publike dhe për të inkurajuar konkurrencën dhe zhvillimin e vendit. Ajo luan gjithashtu një rol thelbësor në procesin e integritimit evropian (IE) duke e bërë të mundur zbatimin e reformave thelbësore dhe dialogun efikas të anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). Prandaj, kriteret e zgjerimit të BE-së njohin dhe theksojnë nevojën që vendet të krijojnë një administratë publike të

fortë që ka kapacitetin të zbatojë Parimet e qeverisjes së mirë publike dhe që transponon dhe zbaton *acquis* e BE-së në mënyrë efikase.

Për të forcuar fokusin e tij në reformën e administratës publike (RAP), Komisioni Evropian (KE) ka theksuar gjashtë çështje kryesore të reformës¹ dhe po integron më mirë reformën në procesin e anëtarësimit nëpërmjet Grupeve të Veçanta të RAP-it dhe lidhjeve më të forta me negociatat e anëtarësimit. Këto gjashtë fusha kryesore të reformës përbëjnë bazën e Parimeve të Administratës Publike.

QËLLIMI DHE FOKUSI I PARIMEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Parimet përkufizojnë se çfarë përfshin qeverisja e mirë në praktikë dhe përcaktojnë kërkesat kryesore që duhet të respektohen nga vendet gjatë procesit të IE-së. Parimet përmbajnë gjithashtu kuadrin e monitorimit, i cili mundëson analizën e rregullt të progresit të zbatimit të Parimeve dhe caktimin e standardeve që duhet të përmbushë vendi.

Koncepti i qeverisjes së mirë është përkufizuar vazhdimisht nga vendet e BE-së dhe është përfshirë në Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore². Nocioni i Hapësirës Administrative Evropiane është krijuar nga SIGMA në vitin 1999.³ Ai përfshinte komponentë të tillë si besueshmëria, parashikueshmëria, llogaridhënia dhe transparencja, si dhe kompetencat teknike dhe menaxheriale, kapaciteti organizativ, qëndrueshmëria financiare dhe pjesëmarrja e qytetarëve.

Ndonëse kriteret e përgjithshme të qeverisjes së mirë janë universale, Parimet janë hartuar për vendet që kërkojnë të anëtarësohen në BE dhe që marrin ndihmë nga BE-ja përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA). Kërkesat e *acquis* të BE-së, si dhe udhëzimet dhe instruksionet e tjera të BE-së, janë thelbi i Parimeve në ato fusha ku ekziston *acquis*. Në fushat e tjera, Parimet rrjedhin nga standardet dhe kërkesat ndërkombëtare, si dhe nga praktikat e mira në vendet anëtare të BE-së dhe të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD). Si standard minimal i një administrate të mirë, vendet duhet të sigurojnë respektimin e këtyre Parimeve themelore.

Vëmendja e qeverisë ndaj Parimeve specifike mund të ndryshojë nga një vend në tjetrin, në varësi të strukturave të qeverisjes së vendit, kulturës administrative, arritjeve të

* Shikoni shënimet fundore, f. 32.

mëparshme të reformës dhe sfidave kyçe të vendit. Kuadri i monitorimit përcakton një grup koherent të kërkesave për të gjitha vendet, duke i lejuar secilit vend njëfarë fleksibiliteti për vendosjen e sfidave dhe objektivave e tij për RAP-in.

Parimet mbulojnë fushën e sektorit publik që njihet si “administrata shtetërore”. Nisur nga përdorimi i gjerë në vendet e Ballkanit Perëndimor, ky term tregon dy elementët kryesorë të objektit të Parimeve: “administratë publike” në “nivel shtetëror (kombëtar ose qendror)”. Parimet mbulojnë gjithashtu organet kushtetuese të pavarura, si

KUADRI ANALITIK DHE I MONITORIMIT

Parimet plotësohen nga një kuadër monitorimi, i cili bën të mundur vlerësimin e gjendjes së administratës publike në një kohë të caktuar, si dhe progresin e bërë gjatë kohës. Kuadri i monitorimit paraqet një sërë treguesish sasiorë dhe cilësorë, duke u fokusuar si në parakushtet e reformave të suksesshme (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira) ashtu edhe në zbatimin aktual të reformave dhe rezultateve që pasojnë këto reforma (mënyra se si administrata punon në praktikë). Për të analizuar progresin që një vend po bën lidhur me zbatimin e Parimeve, këta tregues masin maturinë e komponentëve përkatës të administratës publike, duke dhënë një vlerë të përgjithshme midis 0 (më e ulëta) dhe 5 (më e larta). Për çdo Parim, kuadri analitik përfshin përkufizimin e qasjes metodologjike dhe rendit burimet e informacionit që janë konsultuar për analiza dhe për grumbullimin e të dhënave. Qasja e përgjithshme pranon se nuk ekziston asnjë metodë e vetme e matjes që mund të trajtojë plotësisht

dhe parlamentin dhe gjyqësorin, brenda fushës së kontrollit të tyre dhe kompetencave mbikëqyrëse mbi administratën shtetërore.

Shkalla në të cilën vendet kandidatë ose kandidatë potenciale zbatojnë këto parime në praktikë është tregues i kapacitetit të administratës së tyre kombëtare publike për të zbatuar në mënyrë efiksase *acquis*, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Këshilli Evropian në Kopenhagën (1993) dhe Madrid (1995).

çështjet komplekse që lidhen me ndryshimet organizative dhe ndryshimet e sjelljes sociale. Duke qenë se RAP-i merret pothuajse ekskluzivisht me çështje të tilla, është e nevojshme të sigurohet sa më shumë informacion që të jetë e mundur nga të dhënat administrative, sondazhet, statistikat, intervistat, etj., dhe më pas ky informacion të krahasohet dhe kontrollohet në mënyrë aktive për të arritur në një vlerësim të ekuilibruar. Prandaj, treguesit janë të përbërë nga një kombinim nën-treguesish që bazohen në metodologji të ndryshme.

SIGMA mbledh provat dhe të dhënat e nevojshme për monitorimin e performancës dhe progresit të vendeve gjatë procesit të vlerësimit të RAP-it. Kuadri mund të përdoret gjithashtu edhe nga qeveritë kombëtare (p.sh., institucionet që koordinojnë ose zbatojnë agjendën e RAP-it) ose nga institutet lokale apo organizatat e shoqërisë civile.



Parimet mbulojnë nivelet kryesore horizontale të sistemit të qeverisjes,
të cilat përcaktojnë performancën e përgjithshme të administratës publike.

1

Korniza strategjike e reformës së administratës publike

2

Zhvillimi dhe koordinimi i politikave

3

Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

4

Llogaridhënia

5

Ofrimi i shërbimeve

6

Menaxhimi i financave publike

1

Korniza Strategjike
e Reformës së
Administratës Publike



Korniza Strategjike e Reformës së Administratës Publike

PARIMET

PARIMI 1:

Qeveria e ka hartuar dhe miratuar një agjendë efikase për reformën e administratës publike e cila trajton sfidat kryesore.

PARIMI 2:

Reforma e administratës publike zbatohet me vendosmëri; janë përcaktuar rezultatet e reformës dhe ato monitorohen në mënyrë të rregullt.

PARIMI 3:

Sigurohet qëndrueshmëria financiare e reformës së administratës publike.

PARIMI 4:

Reforma e administratës publike ka struktura koordinuese të fuqishme dhe funksionale si në nivelin politik ashtu edhe në atë administrativ për të drejtuar procesin e hartimit dhe zbatimit të reformës.



PARAKUSHTET PËR REFORMA TË SUKSESSHME (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira)

- Prioritizimi i RAP-it në dokumentet kryesore të planifikimit horizontal.
- Koherenca e dokumenteve të planifikimit të RAP-it.
- Gjithëpërfshirja e sistemeve të raportimit dhe monitorimit të RAP-it.
- Veprimet e RAP-it me kosto të vlerësuar (%).
- Krijimi i llogaridhënies organizative dhe menaxheriale për RAP-in.

ZBATIMI I REFORMAVE DHE REZULTATEVE PASUESE

- Orientimi i dokumenteve të planifikimit të RAP-it drejt reformës.
- Cilësia e konsultimeve të dokumenteve të planifikimit në lidhje me RAP-in.
- Shkalla e zbatimit të aktiviteteve të RAP-it (%).
- Përbushja e objektivave të RAP-it (%).
- Financimi aktual i agjendës së RAP-it.

2

Zhvillimi dhe koordinimi
i politikave



Zhvillimi dhe koordinimi i politikave

PARIMET

PARIMI 1:

Institucionet e Qendrës së Qeverisë përmbushin të gjitha funksionet kritike të një sistemi të organizuar mirë, të qëndrueshëm dhe kompetent të politikëbërjes.

PARIMI 2:

Janë përcaktuar dhe zbatohen procedura të qarta horizontale për menaxhimin e procesit kombëtar të integritit evropian nën koordinimin e organit përgjegjës.

PARIMI 3:

Ekziston një planifikim afatmesëm i harmonizuar i politikave, me objektiva të qarta për tërë qeverinë, dhe ai është përshtatur me rrethanat financiare të qeverisë; politikat sektoriale realizojnë objektivat e qeverisë dhe janë në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm.

PARIMI 4:

Ekziston një sistem i harmonizuar i planifikimit afatmesëm për të gjitha proceset me rëndësi për integrimin evropian dhe ai është i integruar në planifikimin e politikave të brendshme.

PARIMI 5:

Monitorimi i rregullt i performancës së qeverisë mundëson kontrollin publik dhe mbështet qeverinë në arritjen e objektivave të saj.

PARIMI 6:

Vendimet e qeverisë përgatiten në mënyrë transparente dhe bazohen në gjykimin profesional të administratës; sigurohet përputhshmëria me ligjin.

PARIMI 7:

Parlamenti kontrollon politikë-bërjen e qeverisë.

PARIMI 8:

Struktura organizative, procedurat dhe caktimi i stafit të ministrive siguron që politikat dhe legjislacioni i hartuar janë të zbatueshme dhe realizojnë objektivat e qeverisë.

PARIMI 9:

Procedurat e integritit evropian dhe struktura institucionale formojnë pjesë integrale të procesit të hartimit të politikave dhe sigurojnë transpozimin sistematik dhe në kohë të *acquis* të Bashkimit Evropian.

PARIMI 10:

Politikëbërja dhe procesi i hartimit të ligjeve bazohen në evidenca dhe vlerësimi i ndikimit përdoret rregullisht në të gjitha ministrinë.

PARIMI 11:

Politikat dhe legjislacioni hartohen në një mënyrë gjithëpërfshirëse, e cila mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë dhe mundëson koordinimin e këndvështrimeve të ndryshme brenda qeverisë.

PARIMI 12:

Legjislacioni është konsekuent për sa i takon strukturës, stilit dhe gjuhës; kërkesat e hartimit të ligjeve zbatohen në mënyrë konsekuente në të gjitha ministrinë; legjislacioni vihet në dispozicion të publikut.



PARAKUSHTET PËR REFORMA TË SUKSESSHME (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira)

- Institucionalizimi i organizimeve koordinuese midis institucioneve të QQ-së.
- Disponueshmëria e udhëzimeve për ministritë e linjës gjatë procesit të planifikimit të politikave.
- Harmonizimi midis dokumenteve të planifikimit të politikave qendrore.
- Paraqitja në kohën e duhur nga ana e ministrive e rendit të ditës të rregullt në seancën e qeverisë (%)
- Përdorimi i mjeteve themelore analitike dhe teknikave për të vlerësuar ndikimet e mundshme të projektligjeve të reja.

ZBATIMI I REFORMAVE DHE REZULTATEVE PASUESE

- Plotësia e vlerësimeve financiare në strategjitë sektoriale.
- Shkalla e zbatimit të planeve të qeverisë për angazhimet legjislative të lidhura me Integrimin Evropian (%).
- Hapja e procesit të vendimmarrjes së qeverisë.
- Qartësia dhe qëndrueshmëria e politikëbërjes së qeverisë e perceptuar nga bizneset (%)
- Përdorimi i procedurave të jashtëzakonshme për miratimin e projektligjeve të sponsorizuara nga qeveria (%).

3

Shërbimi civil dhe
menaxhimi i burimeve
njerëzore



Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

PARIMET

PARIMI 1:

Objekti i shërbimit civil është i përshtatshëm, i përkufizuar qartë dhe i zbatueshëm në praktikë.

PARIMI 2:

Është krijuar dhe është duke u zbatuar në praktikë korniza politike dhe ligjore për një shërbim civil profesional dhe koherent; struktura institucionale mundëson praktika të qëndrueshme dhe efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore në tërë shërbimin civil.

PARIMI 3:

Punësimi i nëpunësve civilë bazohet në merita dhe trajtim të barabartë në të gjitha fazat e tij; kriteret për uljen në detyrë dhe për përfundimin e marrëdhënieve të punësimit në shërbimin civil janë të qarta.

PARIMI 4:

Parandalohet ndikimi politik i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë në pozicionet e nivelit të lartë drejtues.

PARIMI 5:

Sistemi i shpërblimit të nëpunësve civilë bazohet në klasifikimin e vendeve të punës; ai është i drejtë dhe transparent.

PARIMI 6:

Sistemi i shpërblimit të nëpunësve civilë bazohet në klasifikimin e vendeve të punës; ai është i drejtë dhe transparent.

PARIMI 7:

Ekzistojnë masat për promovimin e integritetit dhe për parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës në shërbimin civil.



PARAKUSHTET PËR REFORMA TË SUKSESSHME (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira)

- Ekzistenca e një organi qendror koordinues të aftë.
- Disponueshmëria dhe përdorimi i të dhënave për shërbimin civil.
- Përshtatshmëria e kornizës ligjore për rekrutimin e bazuar në meritë për pozicionet e nivelit të lartë drejtues të shërbimit civil.
- Objektiviteti i kritereve për përfundimin e marrëdhënieve të punësimit në legjislacionin e shërbimit civil.
- E drejta për të ankimuar në gjykata vendimet për lirim nga shërbimi civil dhe uljen në detyrë.

ZBATIMI I REFORMAVE DHE REZULTATEVE PASUESE

- Koha e kërkuar për të punësuar një nëpunës civil.
- Shkalla e mbajtjes së nëpunësve civilë të sapo punësuar (%).
- Vendimet e shkarkimit të konfirmuara nga gjykatat (%).
- Zbatimi në praktikë i procedurave të rekrutimit për nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues.
- Niveli i perceptuar i meritokracisë në sektorin publik (%).

4

Llogaridhënia

**PARIMI 1:**

Organizimi i përgjithshëm i qeverisë qendrore është racional dhe ndjek politika dhe rregullore të përshtatshme dhe mundëson llogaridhënien e brendshme të duhur politike, gjyqësore, sociale dhe të pavarur.

PARIMI 2:

E drejta për të pasur akses në informacionin publik është e parashikuar në legjislacion dhe zbatohet vazhdimisht në praktikë.

PARIMI 3:

Ekzistojnë mekanizma funksional për mbrojtjen si të të drejtave të individit për qeverisje të mirë ashtu edhe të interesit publik.

PARIMI 4:

Garantohet trajtimi i drejtë i çështjeve administrative përmes ankesave të brendshme administrative dhe shqyrtimeve gjyqësore.

PARIMI 5:

Autoritetet publike marrin përgjegjësi në rastet e shkeljeve dhe garantojnë korrigjimin dhe/ose kompensimin e duhur.



PARAKUSHTET PËR REFORMA TË SUKSESSHME (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira)

- Forca e mekanizmave bazë të llogaridhënies midis ministrive dhe organeve të varësisë.
- Përshtatshmëria e legjislacionit për aksesin në informacionin publik.
- Gjithëpërfshirja e monitorimit të zbatimit të legjislacionit për aksesin në informacionin publik.
- Disponueshmëria publike e vendimeve gjyqësore.
- Mbulimi i regjimit të përgjegjësisë publike për të gjitha organet që ushtrojnë autoritet publik.

ZBATIMI I REFORMAVE DHE REZULTATEVE PASUESE

- Delegimi i autoritetit vendimmarrës brenda ministrive.
- Proaktiviteti në publikimin e të dhënave nga qeveria qendrore (%).
- Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit (%).
- Besimi nga popullsia në institucionet e mbikëqyrjes (%).
- Shkalla e zgjidhjes së çështjeve në gjykatat administrative të shkallës së parë (%).

5

Ofrimi i shërbimeve



Ofrimi i shërbimeve

PARIMI 1:

Ekzistojnë dhe zbatohen politikat për një administratë shtetërore të orientuar drejt qytetarit.

PARIMI 2:

Administrata e mirë është objektiv kyç i politikave që thekson ofrimin e shërbimeve publike që është e parashikuar në legjislacion dhe zbatohet në mënyrë konsekuente në praktikë.

PARIMI 3:

Ekzistojnë mekanizmat për sigurimin e cilësisë së shërbimeve publike.

PARIMI 4:

Garantohet aksesueshmëria në shërbimet publike.



PARAKUSHTET PËR REFORMA TË SUKSESSHME (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira)

- Ekzistenca dhe shtrirja e zbatimit të politikës së ofrimit të shërbimeve.
- Ekzistenca e koordinimit qendror për projektet e qeverisë digjitale.
- Monitorimi qendror i performancës së ofrimit të shërbimeve.
- Njohja ligjore dhe përbalueshmëria e nënshkrimeve elektronike.
- Përshtatshmëria e kuadrit të politikave për përdoruesit e shërbimeve publike me nevoja të veçanta.

ZBATIMI I REFORMAVE DHE REZULTATEVE PASUESE

- Rinovimi i dokumentit personal të identifikimit
- Shfuqizimet ose ndryshimet e vendimeve të organeve administrative të bëra nga gjykata administrative (%)
- Përdorimi i mjeteve dhe teknikave të menaxhimit të cilësisë
- Ndërveprimi i regjistrave bazë
- Koha dhe kostoja e perceptuar nga qytetarët për aksesimin e shërbimeve publike (%).

6

Menaxhimi financiar
publik

**PARIMI 1:**

Qeveria publikon Programin Buxhetor Afatmesëm për qeverinë në përgjithësi i cili bazohet në parashikime të besueshme dhe mbulon një periudhë kohore minimale prej tre vitesh; të gjitha organizatat buxhetore veprojnë në bazë të tij.

PARIMI 2:

Buxheti formulohet në përputhje me kornizën ligjore kombëtare, me shuma të caktuara gjithëpërfshirëse të shpenzimeve që janë në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm dhe që respektohen.

PARIMI 3:

Ministria e Financave (ose autoriteti qendror i autorizuari i thesarit) kontrollon në mënyrë të centralizuar shpërndarjen e fondeve nga llogaria unike e thesarit dhe siguron likuiditetin e parasë në kesh.

PARIMI 4:

Ekziston një strategji e qartë për menaxhimin e borxhit, e cila zbatohet dhe në këtë mënyrë respektohet objektivi i përgjithshëm i vendit për borxhin dhe mbahen nën kontroll kostot e shlyerjes së borxhit.

PARIMI 5:

Transparenca dhe kontrolli i hollësishëm i buxhetit janë të siguruara.

PARIMI 6:

Kuadri operacional i menaxhimit dhe kontrollit financiar përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat dhe zbatimin e tij nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon menaxhimin e financave publike dhe administratën publike në përgjegjësi.

PARIMI 7:

Të gjitha organizatat publike zbatojnë menaxhimin dhe kontrollin financiar në pajtim me dokumentet e përgjithshme të politikës së kontrollit të brendshëm.

PARIMI 8:

Kuadri operacional i auditimit të brendshëm pasqyron standardet ndërkombëtare dhe zbatimi i tij nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon administratën publike dhe menaxhimin financiar publik në përgjithësi.

PARIMI 9:

Të gjitha organizatat publike zbatojnë auditimin e brendshëm në përputhje me dokumentet e përgjithshme të politikave të auditimit të brendshëm, që janë të përshtatshme për organizatën.

PARIMI 10:

Rregulloret e prokurimit publik (duke përfshirë edhe Partneritetet Publike Private dhe Koncesionet) janë harmonizuar me *acquis* të Bashkimit Evropian, përfshijnë fusha plotësuese që nuk mbulohen nga *acquis*, janë harmonizuar me rregulloret përkatëse në fushat e tjera dhe zbatohen siç duhet.

PARIMI 11:

Ekziston kapaciteti qendror institucional dhe administrativ për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar politikën e prokurimit në mënyrë efektive dhe efikase.



PARIMI 12:

Sistemi ankimor është harmonizuar me standardet e *acquis* të Bashkimit Evropian për pavarësinë, ndershmërinë dhe transparecën dhe mundëson trajtimin e shpejtë dhe të përshtatshëm të ankesave dhe sanksioneve.

PARIMI 13:

Aktivitetet e prokurimit publik respektojnë parimet themelore të trajtimit të barabartë, mos-diskriminimit, proporcionalitetit dhe transparecës, ndërkohë që sigurojnë përdorimin e fondeve publike në mënyrën më efektive të mundshme dhe përdorimin më të mirë të mundshëm të teknikave dhe metodave moderne të prokurimit.

PARIMI 14:

Autoritetet dhe subjektet kontraktore kanë kapacitetet e duhura dhe udhëzimet dhe instrumentet praktike për të siguruar menaxhimin profesional të ciklit të plotë të prokurimit.

PARIMI 15:

Pavarësia, mandati dhe organizimi i Institucionit Suprem të Auditimit përcaktohen dhe mbrohen nga kuadri kushtetues dhe ligjor dhe respektohen në praktikë.

PARIMI 16:

Institucioni Suprem i Auditimit zbaton standardet në mënyrë neutrale të paanshme dhe objektive për të siguruar auditime të cilësisë së lartë që ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik.



PARAKUSHTET PËR REFORMA TË SUKSESSHME (ligjet, politikat, strukturat dhe procedurat e mira)

- Forca e rregullave fiskale.
- Qartësia e standardeve kombëtare të kontabilitetit dhe përputhshmëria me standardet ndërkombëtare.
- Plotësia e kuadrit rregullator për kontrollin e brendshëm.
- E drejta për të kundërshtuar vendimet e prokurimit publik.
- Përputhshmëria e metodologjisë së auditimit me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

ZBATIMI I REFORMAVE DHE REZULTATEVE PASUESE

- Besueshmëria e planeve afatmesme të të ardhurave (%).
- Diferenca midis nivelit të borxhit të sektorit publik dhe objektivit (%).
- Cilësia e raporteve të auditimit të brendshëm.
- Koha faktike e trajtimit të ankesave në sistemin e prokurimit publik.
- Efektiviteti i perceptuar nga qytetarët i institucioneve supreme të auditimit (%).



1. KE (2014) *Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2014-15*, Komunikim i Komisionit [Evropian] për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve; COM(2014) 700 final, 8.10.2014, KE, Bruksel https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-strategy-paper_en.pdf
2. Neni. 41. E drejta për administratë të mirë. 1) Çdo person ka të drejtë që çështjet e tij apo të saj të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda një kohe të arsyeshme nga institucionet, organet dhe agjencitë e Bashkimit [Evropian]. 2) Kjo e drejtë përfshin: të drejtën e secilit person për t'u dëgjuar para se të merret çfarëdo mase individuale, e cila do ta prekte atë negativisht; të drejtën e çdo personi të ketë qasje në dosjen e tij apo të saj, duke respektuar interesat legjitime të konfidencialitetit dhe të fshehtësisë profesionale dhe tregtare; detyrimin që administrata të japë arsye për vendimet e saj. 3) Çdo person ka të drejtën që Komuniteti [Bashkimi Evropian] t'i shlyejë çdo dëm të shkaktuar nga institucionet e tij ose nga nëpunësit e tij në kryerjen e detyrave të tyre, në përputhje me parimet e përgjithshme të përbashkëta të ligjeve të Shteteve Anëtare. 4) Çdo person mund t'u shkruajë institucioneve të Bashkimit Evropian në një nga gjuhët e Traktateve dhe duhet të marrë një përgjigje në të njëjtën gjuhë.
3. OECD (1999) *Parimet Evropiane të Administratës Publike*, Dokumentet e SIGMA-s, Nr. 27, Botimet e OECD-së, Paris, <https://doi.org/10.1787/5kml60zwdr7h-en>



Nën-parimet që specifikojnë kërkesat sipas secilit Parim dhe metodologjia analitike paraqiten në versionin e plotë të *Parimeve të Administratës Publike*, i cili është në dispozicion në formë elektronike në faqen e internetit të OECD/SIGMA-s:

www.sigmaweb.org

Për më shumë informacion:

OECD/SIGMA
2 Rue André Pascal
75775 Paris Cedex 16
France

mailto: sigmaweb@oecd.org
Tel: +33 (0) 1 45 24 82 00

www.sigmaweb.org